



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1117/5 prot.

Tiranë më 27.7.2021

REKOMANDIM

Nr. 25, datë 27.7.2021

PËR KONTROLLUESIN “QENDRA KOMBËTARE E CILËSISË, SIGURISË
DHE AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar (në vijim, “*Ligji*”), ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” (në vijim “*Kodi i Procedurave Administrative*”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit Të Institucioneve Shëndetësore”

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 93, datë 25.06.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit Të Institucioneve Shëndetësore” (në vijim, “*Kontrolluesi*”), me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, lidhur me administrimin e bazave të të dhënave shtetërore.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit, vëren se:

1. Kontrolluesi është strukturë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e ngritur për të zbatuar strategjitë afatgjate lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe sigurisë të kujdesit shëndetësor, nëpërmjet metodave të matjes dhe zbatimit të standardeve të treguesve të matshëm për sistemin shëndetësor.

Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se Kontrolluesi ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Nga ana tjetër, nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka kryer përditësimin përkatës për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sa i përket:

- (i) deklarimin në rubrikën 1, *“Të dhënat e subjektit kontrollues”*;
- (ii) deklarimin në rubrikën 3, *“Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen”*;
- (iii) deklarimin në rubrikën 6, *“qëllimi i përpunimit”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e dhënave të tyre, që kryen Kontrolluesi, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore të Kontrolluesit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

2. Kontrolluesi nuk ka vendosur *“politikat e privatësisë”* në faqen zyrtare <http://qkcsaish.gov.al> me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale. Informacioni i publikuar në *“politikën e privatësisë”*, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë faqe mbi mënyrat e përpunimit, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e Kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare, ka detyrimin që të publikojë *“politikën e privatësisë”*, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes online të internet. Mungesa e kësaj rubrike të veçantë në faqen zyrtare të Kontrolluesit, privon subjektet e të dhënave personale nga e drejta për informim, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit.

3. Kontrolluesi ka hartuar *“Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, por përmbajtja e saj është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore, sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon Kontrolluesi, si dhe kategorive të subjekteve të të dhënave (deklaruar në *“Formularin e Njoftimit”*), në referim të parimeve ligjore dhe rregullave specifike të parashikuara në udhëzimet specifike të miratuara nga Komisioneri. Dokumenti i hartuar nga Kontrolluesi është i ngjashëm me rregulloren tip të publikuar në faqen e internetit të Zyrës së Komisionerit dhe nuk reflekton të gjitha proceset përpunuese.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një rregulloreje të posaçme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave

personale (për çdo kategori subjektsh të të dhënave), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim mjaft i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Kjo rregullore duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale, si dhe për çdo kategori subjektsh të të dhënave, sipas deklarimeve në "Formularin e Njoftimit".

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës dhe, në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Kontrolluesit paraqiti pretendimet me shkrim, si dhe dokumente ilustruese për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si më poshtë:

- Lidhur me konstatimin e përditësimit të "*Formularit të Njoftimit*" Kontrolluesi ka paraqitur formularin e njoftimit të përditësuar më datë 28.06.2021;
- Sa i përket konstatimit për përditësimin e rregullores së brendshme, "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*" Kontrolluesi ka rishikuar dhe përditësuar rregulloren e brendshme;
- Lidhur me konstatimin e vendosjes së "*polititës së privatësisë*" në faqen zyrtare <http://qkcsaish.gov.al>, Kontrolluesi ka vendosur menjëherë në faqen zyrtare të tij "*politikat e privatësisë*".

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ dhe reagimin e tij për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe eviton mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 27, 29, 30, 31 pika 1, germa "a/1", si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të ketë në vëmendje përmbushjen në vazhdim të detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, për qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, kategoritë e të dhënave

të përpunuara, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë;

2. Kontrolluesi të ketë në vëmendje në vazhdim, përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në nenet 21 dhe 22 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të ketë në vëmendje masat e sigurisë në drejtim të garantimit të procesit përpunimit të të dhënave në përputhje me veprimtarinë dhe proceset përpunuese që kryen.
4. Në rast mospërmbushjeje, të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më datë 27.7.2021

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

